

## KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR

### **FTESË PUBLIKE PËR BASHKËPUNIM DREJTUAR ORGANEVE TË MEDIAS AUDIOVIZIVE, MEDIAS SË SHKRUAR, MEDIAS ONLINE DHE ASAJ ELEKTRONIKE, PËR TË SHPREHUR INTERESIN PËR TË KONTRIBUAR NË VEPRIMTARITË E KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR DHE GRUPEVE TË EKSPERTËVE**

Komisioni i Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian” bazuar në vendimmarrjet e Kuvendit të Shqipërisë përkatësisht, Rezolutën datë 27.5.2024, Vendimin nr. 50/2024 dhe Vendimin nr. 53/2024, është ngarkuar për drejtimin e një reforme të fokusuar në 3 fusha kyçe: 1) Mirëqeverisja; 2) Antikorrupsioni dhe 3) Sundimi i ligjit. *(Për më shumë informacion, lutemi shihni Rezolutën dhe Vendimet e Kuvendit).*

Komisioni i Posaçëm Parlamentar, për të siguruar një proces sa më gjithëpërfshirës, transparent dhe profesional dhe konform standarteve më të mira ndërkombëtare, në reflektim e përmbushje të rekomandimeve të BE në këto fusha, duke njohur dhe respektuar lirinë e shprehjes dhe të informimit, duke vlerësuar krijimin e një dialogu konstruktiv me komunitetin e medias si dhe duke vlerësuar kontributin aktiv të medias në fushat objekt të veprimtarisë së tij, shpreh interesin t’ju drejtohet me një **Ftesë publike për bashkëpunim** të gjithë organeve të medias audiovizive, medias së shkruar, medias online dhe asaj elektronike, të cilat kanë në fokus të angazhimit të tyre trajtimin e çështjeve që lidhen me 3 fushat kryesore objekt pune të këtij komisioni.

Përmes kësaj ftese publike, mirëpresim shprehjen e interesit nga komuniteti i medias, për përfshirje aktive në aktivitetet e organizuara gjatë këtij procesi dhe angazhimin për të ofruar kontributet e tyre në këtë process, në tryezat e punës së Grupit të Ekspertëve, etj.

Për çdo komunikim të mëtejshëm, ju ftojmë të na kontaktoni në adresën elektronike: [KomisioniPosacem@parlament.al](mailto:KomisioniPosacem@parlament.al).